



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## Abstrakti i raportit përfundimtar i revizionit

### Subjektet kyçe të përfshira me raportin e revizionit

Komuna e Aerodromit

### Lënda e revizionit:

Revizioni i raporteve financiare dhe revizioni i pajtueshmërisë i llogarisë së buxhetit themelor (630) për vitin 2020

### Qëllimi i revizionit:

Të fitohet bindje e arsyeshme nëse raporti financiar është i liruar nga paraqitjet e gabuara materialisht, ndërsa aktivitetet dhe transaksionet që reflektojnë janë në pajtim me rregullativën ligjore.

### Gjendjet kyçe të konstatuara:

- Dobësi gjatë zbatimit të procesit të buxhetimit;
- Të hyrat e pa realizuara nga tatimet komunale për shfrytëzimin e hapësirës për parkim të mjeteve motorike në territorin e komunës, ku me parkingjet menaxhojnë NP Parkingu i Qytetit - Shkup;
- Parregullsi në mënyrën dhe procedurën e dhënies në shfrytëzim të hapsirave afariste, pajisjeve urbane dhe objekteve sportive.

### Mendimi i dhënë \*:

Shprehëm mendim me rezervë për të vërtetën dhe objektivitetin e raporteve financiare, llogaria e buxhetit themelor (630) për vitin 2020 dhe për pajtueshmërinë me rregullativën ligjore, udhëzimet dhe politikat e vendosur.

### Rekomandimet kyçe:

- autorizimet (të përgjithshme ose të veçanta) do t'i jepen një ose më shumë personave drejtues, të cilët në mënyrë hierarkike janë të rregulluar te kryetari i komunës;
- lidhja e marrëveshjes me NP "Parkingu i Qytetit - Shkup" për rregullimin e të drejtave dhe detyrimet në pajtim me Ligjin për tatimet komunale;
- Marrëveshjet për dhënien në shfrytëzim të sendeve në pronësi të komunës të harmonizohen me aktet ligjore dhe nënligjore.

### Dobësitë kyçe të sistemit:

Dobësitë në Ligjin për tatimet komunale të numrat tariforë 9 dhe 10, tatime komunale për shfrytëzimin e rrugicave dhe rrugëve dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik.  
Dobësitë në Ligjin për tatimin në pronë për harmonizimin e gjendjes së regjistrit të patundshmërive të komunave me regjistrin që mbahet në AKP-në e RMV-së.

### Vërejtjet e marra të draft-raportit:

Nuk janë marrë vërejtje të draft-raportit i llogarisë së buxhetit themelor (630) për vitin 2020

### Përgjigjet e vërejtjeve të marra:

/

\* pozitive, me rezervë, të pavolitshën, të përmbajtur